REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. U. 05 Nr. Br. 27522
Nr. i faq. Br. str. 22 Data: Datum: 05/09
KAMENICË/A 2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET**

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | Kryetarin e Komunës - z. Qëndron Kastrati<br>Kryesuesin e Kuvendit Komunal-z .Albert Sërmaxhaj |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| | |
| NGA/OD/FROM: | Drejtor i DFB-së - z. Sinbad Sonki |
| TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT: | **Propozim - Buxheti 2020-2022** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Zyrës:<br>Br. Kancelarije:<br>Room No: | | Lokacioni:<br>Lokacija:<br>Extencion: | | Data:<br>Datum:<br>Date: | 04.09.2018 |

| | |
|---|---|
| Për aktivitet/Za aktivnost/For action/ | |
| Për miratim/Za usvajanje/For aprovao/ | X |
| Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/ | |
| Për komente/Za komentare/For comments/ | |
| A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss/ | |
| Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/ | |
| Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/ | |
| Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/ | |
| Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/ | |
| Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/ | X |
| Afati/ Rok/Deadline/ | |

**Të nderuar :**

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 61 Shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal paragrafi 61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit,Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës.Pas këtyre dëgjimeve,Kuvendi Komunal,deri më datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenin 20 të këtij ligji,duhet ta shqyrtojë,ndryshoj siç e sheh të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t·ia dorëzoj Ministrit propozim-buxhetin komunal.

**Me respekt**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

# DRAFT
# BUXHETI 2020-2022

0.45%

**KAMENICË :02.09.2019**

Përmbledhje/Shqyrtimet Hyrese/..........................................................

Zhvillimet e Procesit Buxhetor komunal ..................................................

Struktura e Financimit Buxhetor..........................................................

Synimet e qeverisë locale në kuader të planifikimit buxhetor.......................

Kufiji e Financimit..............................................................................

KAPITULLI I

Burimet e Financimit

Granti Qeveritar..................................................................................

Të hyrat vetjake..................................................................................

Kategoritë Ekonomike Buxhetore..........................................................

Pjesëmarrja e kategorive ekonomike ne planifikimin e buxhetit 2020.........

KAPITULLI II

Shpërndarja e Buxhetit........................................................................

Shpërndarja e buxhetit sipas kategorive ekonomike..................................

KAPITULLI III

Tabela Buxhetore..................................................................................

Drejtorite Programet Buxhetore............................................................

Konkluzionet Përmbyllëse....................................................................

**Shqyrtimet Hyrëse:**

BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

- **Neni 61**

61.1 Pas miratimit të propozim –Buxhetit komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës,deri me 1 shtator të vitit përkatës fiskal,duhet t`ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal.

61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës.Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siq e sheh të nevojshme ose të arsyshme si dhe të miratojë dhe t`ia dorëzojë Ministrit propozim-buxhetin Komunal.

61.3 Buxheti i miratuar Komunal duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji dhe udhëzimet e dhëna në qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministri.

**Aktivitetet dhe Zhvillimet Buxhetore**

Procesi i planifikimit të buxhetit, është zhvilluar në përputhje të plotë me kalendarin kohor të përcaktuar nga MF-ja sipas :

- Qarkores Buxhetore 2020/01 të pranuar më 16.05.2019
- Qarkores Interne Buxhetore 1- të dërguar Drejtorëve me 16.05.2019
- Qarkores së dytë 2020/02 të pranuar më datë 07.08.2019
- Qarkores së dytë interne 2-të dërguar Drejtorëve 09.08.2019

Komuna e Kamenicës në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale ka planifikuar buxhetin për vitin 2020-2022 duke u bazuar në Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në aktivitetet e tyre dhe prioriteteve .

Më 30.06.2019, Kuvendi Komunal-Kamenicë ka miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022, si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e hartuar në përputhje me procedurat e parashikuara buxhetore 2020-2022, të dhëna nga MF përmes Qarkores Buxhetore 2020/01. Korniza Afatmesme Buxhetore si dokument strategjik prezenton parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore, strategjinë zhvillimore komunale, totalet e vlerësuara të të hyrave nga të gjitha burimet e financimit, caqet totale te shpenzimeve sipas kategorive ekonomike . Korniza Afatmesme buxhetore 2020-2022 është dorëzuar në MF më datë **30.06.2019.**

Duke u bazuar në fazat e procesit buxhetor komunal 2020-2022 hap shumë I rëndësishum kemi **Dëgjimet buxhetore** në planifikimin e buxhetit për vitin 2020-2022 .Gjatë hartimit të KAB-it Komunalë Komuna e Kamenicës nuk ka mbajtur një debat publik për diskutimin e prioriteteve dhe strategjive komunale. Dëgjimet me qytetar janë mbajtur sipas orarit:

- Dëgjimin e pare/1/ me qytetar në fshatin Karacevë e Poshtme më date 13.08.2019 ora 18.00h
- Dëgjimin e dytë/2/ me qytetar në fshatin Mucivërc më date 14.08.2019 ora 16.00h
- Dëgjimi i tretë/3/ me qytetar në fshatin Topanicë më date 14.08.2019 ora 18.00h
- Dëgjimi i katërtë/4/ me qytetar në fshatin Poliqkë më date 15.08.2019 ora 16.00h
- Dëgjimi i pestë/5/ me banoret e lagjes Malësia më date 15.08.2019 ora 18.00h
- Dëgjimi i gjashtë/6/ me qytetar në fshatin Busavatë më datë 16.08.2019 ora 16.00h
- Dëgjimi i shtatë/7/ me qytetar në Berivojcë më datë 16.08.2019 ora 18.00h
- Dëgjimi i tetë/8/ me qytetar në Lagjën Iliria më datë 17.08.2019 ora 16.00h
- Dëgjimi i nëntë /9/ me qytetar në lagjën Qamëria më datë 17.08.2019 ora 18.00h
- Dëgjimi i dhjetë/10/ me qytetar në bashkësinë locale e Srezovc më datë 20.08.2019 ora 18.00h
- Dëgjimi i njëmbëdhjetë/11/ me qytetar Roganë më date 21.08.2018 ora 16.00h
- Dëgjimi i dymbëdhjetë/12/ me qytetar të Karaceva e Eperme më datë 21.08.2018 ora 18.00h
- Dëgjimi i trembëdhjetë/13/ me qytetar në Koretinë më datë 22.08.2018 ora 16.00h
- Dëgjimi i katërmbëdhjetë/14/ me qytetar në fshatin Petrit më datë 22.08.2018 ora 18.00h
- Dëgjimi i pesëmbëdhjetë/15/ me qytetar në fshatin Shipashnicë e Epërme më datë 23.08.2018 ora 16.00h
- Dëgjimi i gjashtëmbëdhjetë/16/ me qytetar në fshatin Shipashnicë e Poshtme më datë 23.08.2018 ora 18.00h
- Dëgjimi i shtatëmbëdhjetë/17/ me qytetar Komunitetin serb dhe Rom më datë 24.08.2018 ora 18.00h
- Dëgjimi i tetëmbëdhjetë/18/ me qytetar në Hogosht më datë 26.08.2018 ora 16.00h
- Dëgjimi i nëntëmbëdhjetë/19/ me qytetar , Kopernicë më datë 26.08.2018 ora 18.00h

- Dëgjimi i njëzetenjë/20/ me qytetar , Hodonoc më datë 27.08.2018 ora 16.00h
- **D**ëgjimi i njëzetedy /21/me qytetar , Dajkoc më datë 28.08.2018 ora 18.00h
- **D**ëgjimi i njëzetedy /22/me qytetar , Lisockë më datë 28.08.2018 ora 18.00h
- Dëgjimi i njëzetetre/23/ me qytetar , Desivojcë më datë 28.08.2018 ora 18.30h

Komuna e Kamenicës, për vitin 2020 ka një rritje te buxhetit duke krahasuar me vitin 2019 (42.497.00€), ky realitet mundëson të konstatojmë se kjo rritje buxhetore ka rrjedhë si pasojë e rritjes së Grandeve Qeveritare .

## Zhvillimi i procesit buxhetor komunal për vitin 2020

Me qëllim të përmbushjes së afatit ligjor për përgatitjen e projekt buxhetit 2020 është thelbësore që Komuna e jonë ka vepruar në pajtim me kalendarin buxhetor të përcaktuar në LMFPP në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2020/01 dhe 2020/02.
Organizata jonë buxhetore (653) ka zhvilluar procesin e hartimit të draft-buxhetit për vitet 2020-2022, në harmoni të plot me instruksionet e pranuara nga Ministria e Financave përmes qarkoreve buxhetore, si dhe në zbatim të ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi të jetë në përputhje me interesat e përgjithshme të qytetarëve të komunës sonë në përputhje me kufijt e limituar të financimit. Projekt-buxheti sipas burimeve të financimit , përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale të shpërndara në pesë kategori buxhetore dhe nënkategori të shpenzimeve.

Ministria e Financave ka hartuar qarkoret buxhetore bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara si numri i popullsisë, madhësia gjeografike numri i nxënësve, stafi i mësimënsve, stafi professional dhe ndihmës, numri i pakicave kombëtare .Nga këto percaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për vitin 2020 do të jetë në shumën prej **9.401.944.00€.**

**STRUKTURA E FINANCIMIT BUXHETOR**

Struktura e financimit buxhetor të komunës përbëhet prej dy burimeve të financimit dhe atë:

1. GRANDI QEVERITAR:

- Granti i përgjithshëm,
- Granti specifik i arsimit;
- Granti specifik i shëndetësis dhe
- Shërbimet Sociale Rezidenciale

2. TË HYRAT VETJAKE KOMUNALE 2019
3. HUAMARRJA

# Struktura e Financimit

| Pershkrimi | 2,020 | Pjesëmarrja në % |
|---|---|---|
| **Grandi i pergjitheshem** | 4.129.292.00 | 48.35 |
| **Grani i Arsimit** | 3.089.906.00 | 36.18 |
| **Grandi i shendetesise** | 1.150.672.00 | 13.47 |
| Shërbimet Sociale Rezidenciale | 170.000.00 | 2.00 |
| **TOTALI** | **8.539.870.00** | **100.00** |

Buxheti i vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 karakterizohet me rritje të shumës buxhetore për grantin qeveritar/Grandi i Shëndetësisë/ ndërsa zvoglim të vlerës së planifikuar të të hyrave vetjake. Mbështetur në totalin e buxhetit për vitin 2020 rezulton se kemi rritje të vlerës buxhetore krahasuar me vitin 2019 për 0.45 %.

| Përshkrimi | 2019 | 2020 | Krahasimi +/- | Indexi |
|---|---|---|---|---|
| **Shuma e Buxhetit** | 9.359.447.00 | 9.401.944.00 | 42.497.00 | 0.45 % |
| **TOTALI** | 9.359.447.00 | 9.401.944.00 | 42.497.00 | 0.45 % |

*TABELA E GRANDEVE DHE TE HYRAVE 2020/2022*

| PËRSHKRIMI | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|
| Numri i Punëtorëve | 1,172 | 1,186 | 1,186 |
| Grandi i pergjithshëm | 3.804.966.00 | 3.841.099.00 | 4.129.292.00 |
| Grani i Arsimit | 3.061.088.00 | 2.956.524.00 | 3.089.906.00 |
| Huaja për Arsim M/SH | 3.191.00 | 2.127.00 | |
| Huaja për Arsim pë SH/K | 2.127.00 | 1.418.00 | |
| Grandi i shendetesise | 983.072.00 | 1.082.250.00 | 1.150.672.00 |
| Huaja për Shëndetesi M/SH | 86.604.00 | 86.604.00 | |
| Shërbimet sociale Rezidenciale | 165.000.00 | 160.000.00 | 170.000.00 |
| Të hyrat vetjake | 943.989.00 | 1.229.846.00 | 862.074.00 |
| Totali | 9.050.037.00 | 9.359.447.00 | 9.401.944.00 |

*Synimet e qeverisë lokale në kuadër të planifikimit buxhetor.*

*Në* bazë të planifikimit të buxhetit për vitin 2020 dhe krahasuar me buxhetin 2019 Komuna e Kamenicës ka ndryshime në kategori të caktuara ekonomike.

**Shpenzimet rrjedhëse:** Programet /Drejtoritë/ kanë bërë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha drejtoritë iu janë përmbajtur kufijve të dhënë në bazë të Qarkorës 2020/02. për vitet 2020-2022. Shpenzimet operative për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021-2022 do të pësojnë ngritje të lehtë në krahasim me vitin 2019. Kjo rritje ka të bëjë kryesisht me rritje në kategori të pagave dhe mëditjeve .

**Punësimi:** Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit krahasuar me vitin paraprak ,përveq rritjes të stafit me komisionit të Grandeve(stafit për teatro dhe shërbimeve rezidenciale) .

**Kategoria per Paga dhe Meditje-**

Në vitin 2020 kemi një rritje krahasuar me vitin 2019 për 6.06% shprehur në masë monetare prej 431.390.00- kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje historikisht ka përfaqësuar pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse dhe gjithashtu planifikohet që përgjatë periudhës planifikuese trendi i njëjtë të vazhdojë.Në kategorinë e shpenzimeve **Paga dhe mëditje** kalkulimi është bërë duke u bazuar nën supozimin e koeficientëve të rinj që mund të përcaktohen me Ligjin për Pagat në sektorin Publik (parashikimet e herëshme nga MAP) si dhe financimin e satfit për teatrot dhe shërbimet rezidenciale.

. Kriteret që janë marrë për bazë në këtë kategori janë:

- Gjendja e tanishme e punëtoreve aktual,

## Kategoria per Mallra dhe sherbime-

- Ne vitin 2020 kemi nje zvoglim të kësaj kategorie në krahasim me vitin 2019 per 5.91% sipas qarkores 2020/02 .Arsyeja e këtij zvoglimi është rritja e pages në bazë të Ligjit mbi pagat,pastaj kërkesa në bazë të KAB-it për keqklasifikim të shpenzimeve për tri projekte kapitale/Mirëmbajtja e rrugëve, mirëmbajtja e gjelbërimit dhe mirëmbajtja e ndriqimit/ dhe aplikimi i furnizimit me shujtë ditore nxënësve të shkollës fillore .

**Kategoria për shpenzime Komunale –**

- Në vitin 2020 kemi një trend të njejtë të planifikimit të shpenzimeve në krahasim me vitin 2019 .Në bazë të kufijve të dalur nga KASH-i për vitin 2020-2022 del se komuna e

Kamenicës ka bërë planifikimin e buxhetit me trend të njejtë sepse kemi kufijt buxhetor sipas qarkorës 2020/02. Pjesëmarrja e kategorisë për shpenzime komunale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë vitit 2020 do të jetë 1.96% .

**Kategoria per Subvencione**

- -Në vitin 2020 kemi një zvoglim të kësaj kategorie në krahasim me vitin 2019 për 40%. Ky zvoglim është planifikuar për shkak të rritjes nga kategoria për paga dhe mëditje dhe duke I respektuar limitet nga Qarkorja 2020/02 .Në këtë kategori do të përfshihet shpenzimi që ka marrë komuna në shpenzime të varrimit e cila shumë planifikohet të jetë 40.000.00€, kemi kërkesa për subvencionim për biznese të ndryshme dhe aktivitetet e planifikuara nga Grupi i grave dhe Drejtoritë për ekonomi, kemi kërkesa për subvencionim edhe në përkrahje bujqve të komunës, subvencionimi në Drejtori pë KRS për aktivitetet vjetore /manifestimet/, përkrahje klubeve të ndryshme. Pjesëmarrja e kategorisë për subvencione në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës për vitin 2020- do të jetë 1.28%. **Planifikimi në kategori për subvencione dhe transfere duhet të bëhet nga të hyrat vetanake komunale.**

**Kategoria per Investime kapitale**

- Në bazë të kufijve të dalur nga Qarkorja 2020/02 për vitin 2020-2022 del se komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit në shumë prej 652.028.00€ krahasuar me vitin 2019 ka një zvoglim prej 27.90 % apo (252.335.00) €. Pjesëmarrja e kategorisë për investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës për vitin 2020- do të jetë 6.93%.

## Struktura e Investimeve kapitale 2020 ?

Me buxhetin e vitit 2020 sipas Qarkores 2020/02 fondi për kategori të shpenzimeve kapitale e kemi të limituar vetem në shumën prej 652.028.00€ apo 27.90% më pakë se në vitin 2019. Struktura e Investimeve kapitale per vitin 2019, **nga të hyrat vetjake 43.96%**

Struktura e investimeve kapitale do të përmbaj investimet në vijim nga viti 2019 dhe investimet dy vjeqare të kontraktuara.
Projeksionet e shpenzimeve buxhetore në të gjitha katogoritë ekonomike janë hartuar dhe vendosur në këtë draft-buxhet gjithnjë duke patur në konsideratë të gjitha kërkesat e zyrtarëve autorizues/Drejtorëve/ të programeve buxhetore të ofruara në bazë të kërkesave përmes qarkoreve buxhetore interne.

*Në kuadër të administratës së organizatës sonë buxhetore(653) janë paraparë me organogram të miratuar në Kuvend të komunës këto programe :*

**01-Zyra e Kryetarit**
**02-Zyra e Kuvendit**
**03-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**

- *Cështja Gjinore*

**04-Drejtoria e Financave dhe Buxhetit**
**05-Sherbimet Publike Ambientit dhe Inspektoratit**

Në kuadër të Shërbimeve Publike janë paraparë nënprogramet:

- *Infrastruktura Publike*
- *Zjarrëfikësit dhe Inspekcioni*
- *Menaxhimi i katastrofave natyrore*

**06-ZLK**
**07-Bujqësia**
**08-Shërbimet Kadastrale**
**09-Urbanizmi dhe Planifikimi Hapsinor**
**10-Ekonomi,Zhvillim dhe Diasporë**
**11-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

- *Administrata e Shëndetësisë*
- *Shërbimet e shëndetësisë primare*

***Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale***

- *Shërbimet Sociale*
- *Shërbimet sociale rezidenciale*

**12-DKRS**
**13-Arsimi**

- *Administrata -Arsim*
- *Arsimi Parashkollor dhe qerdhet*
- *Arsimi Fillor*
- *Arsimi Mesem*

## Kufijt e financimit

Qarkorja buxhetore 2020/02 ofron instruksioneve mbi ecurin e procesit të hartimit të buxhetit. përcakton qartë edhe limitet e financimit për të gjitha kategoritë. Kategoritë e shpenzimeve operative/ Paga dhe mëditja ,Mallra dhe Shërbime,Komunali,subvencione/ dhe Investimeve kapitale kanë një kufi të përbashkët.

Buxheti i vitit 20200 është i financuar nga dy burime: 1) **Granti qeveritar**, dhe
2) **Të hyrat vetjake**.




## *1.Granti qeveritar*

Financimi i Buxhetit nga granti qeveritar vazhdon të jetë burimi kryesor i përbërjes së buxhetit të komunës. Pothuajse çdo vit kemi shënuar ngritje të vlerës së grantit qeveritar përfshirë të katër grantet, për vitin 2020 kemi një ngritje të grandit qeveritar për 3.36%,.Granti qeveritar si burim parësor i bërjes së buxhetit për vitin fiskal 2020 ka pjesëmarrje prej **90.83%** në totalin e vlerës buxhetore.

| Nr | Emërtimi i Grandit | Shuma e Grandit Qeveritar | Buxheti Total | Pjesemarrja % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Grandi Qeveritar | 8.539.870.00 | 9.401.944.00 | 90.83 |
| | TOTALI | 8.539.870.00 | 9.401.944.00 | 90.83 |

Krahasuar me vitin 2019 totali i Grandeve në vitin 2020 është rritur për 3.36% nga se kemi rritje të Grandit të Përgjithëshëm për 7.50%, të Grandit të Arsimit 4.51% , Shërbimet Sociale rezidenciale zvogëlim për 6.25% dhe Grandit të Shëndetësisë rritje 6.29%.

GRANDI QEVERITAR NE RAPORT 2019/2020

| | Grandet Qeveritare 2019 | Grandet Qeveritare 2020 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|
| **TOTALI** | 8.040.173.00 | 8.539.870.00 | 499.697.00 |

**PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT 2018-2020**






TABELA E NDARJES BUXHETORE NE BAZE TE QARKORES 2020/02

| NR | Kategoria Ekonomike | Kufiri i përcaktuar me qarkore 2018/02 | | Kërkesat e Organizatës Buxhetore |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Stafi** | 1,186 | | 1,186 |
| 2 | **Paga dhe Meditja** | **Fondi 10** | **Fondi 21** | 10+21 |
| | | 7.480.916.00 | 65.000.00 | |
| | | 7.545.916.00 | | 7.545.916.00 |
| 3 | **Mallra dhe Sherbime** | **Fondi 10** | **Fondi 21** | 10+21 |
| | | 601.926.00 | 298.074.00 | |
| | | 900.000.00 | | 900.000.00 |
| 4 | **Shpenzime komunale** | **Fondi 10** | **Fondi 21** | 10+21 |
| | | 184.000.00 | | |
| | | 184.000.00 | | 184.000.00 |
| 5 | **Subvencione** | **Fondi 10** | **Fondi 21** | 10+21 |
| | | | 120.000.00 | |
| | | 120.000.00 | | 120.000.00 |
| 6 | **Investime Kapitale** | **Fondi 10** | **Fondi 21** | 10+21 |
| | | 273.028.00 | 379.000.00 | |
| | | 652.028.00 | | 652.028.00 |
| | Shpenzimet Operative (Mallra,komunale,subvencione) | 785.926.00 | 418.074.00 | |
| | Shpenzimet Kapitale | 273.028.00 | 379.000.00 | |
| | **TOTALI** | **8.539.870.00** | **862.074.00** | **9.401.944.00** |

## 2. *TË HYRAT VETJAKE*

Burimi i dytë i financimit të buxhetit, të hyrat vetjake, marrin pjesë me **9.17 %** të përbërjes së buxhetit për vitin 2020, dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një zvoglim të vlerës së planifikuar për (367.051.00€).

| | Te hyrat totale vetjake 2020 | Totali I Buxhetit 2020 | Pjesemarrja |
|---|---|---|---|
| **Te hyrat Vetjake** | 862.074.00 | 9.401.944.00 | 9.17% |
| **TOTALI** | 862.074.00 | 9.401.944.00 | 9.17% |

Përmes planit të të hyrave 2020 organizata buxhetore pasqyron totalin e planifikuar për vitin buxhetor duke patur për bazë vlerën vjetore si objektiv , si dhe duke e shpërndarë vlerën e parashikuar në të gjitha llojet e të hyrave.

**TABELA E BUXHETIT NGA TE HYRAT VETANAKE 2019/2020**

| | Të hyrat vetjake 2019 | Të hyrat vetjake 2020 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|
| **Te Hyrat Vetjake** | 1.229.125.00 | 862.074.00 | (367.051.00) |
| **TOTALI** | 1.229.125.00 | 862.074.00 | (367.051.00) |

Gjithsesi duhet theksuar se bazë ligjore për grumbullimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake janë ligjet e miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës si: ligji mbi vetëqeverisjen lokale, ligji mbi financat lokale, rregullorja e komunës mbi tarifat dhe ngarkesat komunale si dhe ligji mbi Tatimin në Pronë.

***Tatimi në pronë***

E hyra kryesore në kuadër të të hyrave vetanake është **Tatimi në Pronë+Tatimi në tokë (277.730.00+101.134.00)**, pjesëmarrja në totalin e planifikimit të të hyrave për vitin fiskal 2020 do të jetë 378.864.00 apo **43.95%.**




| **Lloji i të hyrave** | Të hyrat vetjake 2019 | Të hyrat vetjake 2020 | Pjesëmarrja nga të Hyrat totale vetjake 2019 |
|---|---|---|---|
| **Tatimi në Pronë** | 280.000.00 | 277.730.00 | 32.21% |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Tatimi në** tokë | 71.000.00 | 101.134.00 | 11.73% |
| **Të hyrat tjera komunale** | 1.229.125.00 | 862.074.00 | 43.95% |

**Të hyrat nga Arsimi**: Janë të hyra që vijnë kryesisht nga participimi i qytetarëve për shërbimet që kryhen në qerdhen e fëmijëve, si dhe të hyrat nga pagesat për arsimimin e përshpejtuar ;
**Të hyrat nga shëndetësia:** janë ato të hyra që kanë të bëjnë me participimet në shëndetësi nga ana e qytetarëve.

*KATEGORITË BUXHETORE*

Struktura buxhetore përmban pesë kategori ekonomike, dhe atë : **1.Paga dhe meditje; 2.Mallra dhe shërbime; 3.Shpenzime komunale; 4.Subvencione; 5.Shpenzime kapitale .**

Buxheti i vitit 2020 karakterizohet me ngritje të vlerës buxhetore në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve për 6.06% krahasuar me vitin 2019, kemi zvoglim në kategorin "mallra dhe shërbime" për 5.91%, kemi buxhet të njejtë në kategorinë shpenzime komunale ,kemi zvoglim te subvencionet për 40%, kemi zvoglim në kategorinë për shpenzime kapitale për 27.90 % krahasuar me 2019.

| **Kategoritë** | Buxheti 2019 | Buxheti 2020 | Ndryshimi | % |
|---|---|---|---|---|
| **Paga dhe Meditja** | 7.114.526.00 | 7.545.916.00 | 431.390.00 | 6.06% |
| **Mallra dhe Shërbime** | 956.558.00 | 900.000.00 | (56.558.00) | -5.91 |
| **Shpenzime Komunale** | 184.000.00 | 184.000.00 | | |
| **Subvencione** | 200.000.00 | 120.000.00 | (80.000.00) | -40.00 |
| **Investime kapitale** | 904.363.00 | 652.028.00 | (252.335.00) | -27.90 |
| **TOTALI** | 9.359.447.00 | 9.401.944.00 | 42.497.00 | 0.45% |




## Pjesëmarrja e kategorive buxhetore në projekt-buxhetin e vitit 2020

Kategoria "Paga dhe meditje"dominon me pjesëmarrje në tërësin e buxhetit me **80.26%,** ajo mallra dhe shërbime 9.57% , shpenzimet komunale me 1.96%. kategoria e subvencioneve me 1.28% dhe ajo e shpenzimeve kapitale 6.94%.

| NR | Kategoria Ekonomike | Buxheti per vitin 2020 | Totali I Buxhetit | Pjesemarrja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Paga dhe Meditja** | 7.545.916.00 | | 80.26% |
| 2 | **Mallra dhe sherbime** | 900.000.00 | | 9.57% |
| 3 | **Shpenzime komunale** | 184.005.00 | | 1.96% |
| 4 | **Subvencione** | 120.000.00 | | 1.28% |
| 5 | **Investime Kapitale** | 652.028.00 | | 6.94% |
| | TOTALI | 9.401.944.00 | | 100.00% |




## 1. Përcaktimi i prioriteteve

Është e qartë se një ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është ai i përcaktimit të prioriteteve sidomos në pjesën e kategorisë së investimeve kapitale. Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë nevojat e qytetarëve të komunës sonë për të ngritur mirëqenien e tyre. Mbi bazën e këtyre nevojave kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij si dhe në konsultimin me qytetarët e në varësi me mjetet e disponueshme do të ketë përcaktuar prioritetet 2020-2022e në fokus ato të vitit fiskal 2020.

***2. Buxheti në funksion të përmbushjes së nevojave.***

Organizata jonë buxhetore ka të identifikuara nevojat për zhvillim të gjithëmbarshëm por që janë në disproporcion me mundësitë buxhetore. Edhe buxheti i vitit fiskal 2020 do të ndikoj në masë të konsideruar në zhvillimin e komunës sonë në të gjitha sferat por asesi nuk mundë të përmbushë kërkesat e përgjithëshme qytetare. Në këtë drejtim absorbimi i granteve të donatorëve qofshin ato te mbredshme apo te jashtme do të ndikoj pozitivisht në ngritjen e trendit në realizimin e kërkesave zhvillimore e sociale.

***3. Buxheti në përkrahje të zhvillimit ekonomik***

Vlera e limitiuar e buxhetit nuk jep hapsirë dhe mundësi për një ndikim të theksuar në fushën e zhvillimit ekonomik të komunës sonë. Mirëpo investimet me pjesë më të madhe kanë të bëjnë investimet dy vjeqare e që komuna është në marëveshje kontraktuale.

***4. Identifikimi i nevojave***

Kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit ka organizuar 23 (njëzetetre) dëgjime buxhetore me qytetarë, Pothuajse tani janë identifikuar të gjitha nevojat për investime kapitale mirëpo kufizimi i mjeteve buxhetore për këtë kategori medoemos kërkon vendosjen e prioriteteve të projekteve. Ndërsa sa i përket identifikimit të problemeve, nevojave të financuara nga kategorit tjera ekonomike në kuadër të strukturës buxhetore, ato janë më lehtë të identifikueshme sepse ato lindin gjatë ekzekutimit të buxhetit të vitit paraprak, dhe si te tilla prezentohen nga zyrtaret autorizues të programeve , pas pranimit të qarkoreve të mbrendshme buxhetore.

Në k*ëtë drejtim roli i qytetarëve është i pazëvendësueshëm, dhe lypset nga ata që përherë të jenë pjesë e vendim marrjes e sidomos në procesin e hartimit të projekt buxhetit , përmes të cilit ata do të mundë të realizojnë synimet, projektet e tyre në funksion të ngritjes së mirëqenies.*

## 1.SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË PROGRAME BUXHETORE

## 1.SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË PROGRAME BUXHETORE

Në kapitullin II të këtij dokumenti do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit për vitin 2020 në programet buxhetore, kategori dhe nënkategori buxhetore.
Shpërndarja buxhetore në kategori ekonomike gjithnjë është në varshmëri me përcaktimet apo limitet buxhetore të pranuara me qarkoren buxhetore 2020/02.

## Grandi Qeveritar

| Emri I Programit | Stafi | Paga dhe mëditje | Mallra dhe sherbime | shpenzime komunale | Subvencione | Investime kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Kryetarit | 28 | 252,000.00 | 20,000.00 | | | | 272,000.00 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | | 154,000.00 | | | | | 154,000.00 |
| Administrata dhe Personeli | 38 | 234,000.00 | 15,000.00 | | | | 249,000.00 |
| Ceshtja Gjinore | 1 | 7,000.00 | | | | | 7,000.00 |
| Buxhet dhe Financa | 24 | 177,000.00 | | | | | 177,000.00 |
| Ekonomi dhe Diaspore | 5 | 33,000.00 | | | | | 33,000.00 |
| Infrastruktura Publike | 19 | 135,000.00 | 17,926.00 | 93,000.00 | | 128,028.00 | 373,954.00 |
| Zjarrefikset dhe Inspektimet | 33 | 238,000.00 | 31,000.00 | | | | 269,000.00 |
| Menaxhimi I katastrofave natyrore | 6 | 44,000.00 | | | | | 44,000.00 |
| ZLK | 8 | 49,000.00 | | | | 50,000.00 | 99,000.00 |
| Bujqësi dhe Pylltari | 20 | 137,000.00 | | | | | 137,000.00 |
| Kadaster dhe Xheodezi | 10 | 67,000.00 | | | | | 67,000.00 |
| Urbanizem | 11 | 87,000.00 | | | | | 87,000.00 |
| Administrate -Shendetësi | 4 | 31,000.00 | | | | | 31,000.00 |
| Sherbimet e shendetësise Primare | 146 | 1,330,000.00 | 100,000.00 | 32,000.00 | | 75,000.00 | 1,537,000.00 |
| Sherbimet sociale | 13 | 104,000.00 | | | | | 104,000.00 |
| Sherbimet Sociale Rezidenciale | 10 | 83,000.00 | 60,000.00 | 7,000.00 | | 20,000.00 | 170,000.00 |
| Kulture rini dhe sport | 21 | 140,000.00 | 4,000.00 | | | | 144,000.00 |
| Administrate-Arsim | 10 | 95,000.00 | 199,000.00 | 52,000.00 | | | 346,000.00 |
| Arsimi Parashkollor | 22 | 142,000.00 | 15,000.00 | | | | 157,000.00 |
| Arsimi Fillor | 564 | 2,656,916.00 | 98,000.00 | | | | 2,754,916.00 |
| Arsimi I Mesem | 193 | 1,285,000.00 | 42,000.00 | | | | 1,327,000.00 |
| TOTALI | | 7,480,916.00 | 601,926.00 | 184,000.00 | | 273,028.00 | 8,539,870.00 |
| | | 7,480,916.00 | 601,926.00 | 184,000.00 | | 273,028.00 | 8,539,870.00 |

## Të hyrat vetanake

| Emri I Programit | Stafi | Paga dhe mëditje | Mallra dhe sherbime | shpenzime komunale | Subvencione | Investime kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Kryetarit | | | 30,000.00 | | 40,000.00 | | 70,000.00 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | | | 4,000.00 | | | | |
| Administrata dhe Personeli | | | 15,000.00 | | | | |
| Ceshtja Gjinore | | | 500.00 | | | | |
| Buxhet dhe Financa | | | 20,000.00 | | | | |
| Ekonomi dhe Diaspore | | | 8,000.00 | | 10,000.00 | | 18,000.00 |
| Infrastruktura Publike | | | 100,000.00 | | | 80,000.00 | |
| Zjarrefikset dhe Inspektimet | | | | | | | |
| Menaxhimi I katastrofave natyrore | | | 19,000.00 | | | 10,000.00 | |
| ZLK | | | 2,000.00 | | 1,500.00 | | |
| Bujqësi dhe Pylltari | | | 8,000.00 | | 30,000.00 | | 38,000.00 |
| Kadaster dhe Xheodezi | | | 9,000.00 | | | 20,000.00 | |
| Urbanizem | | | 6,000.00 | | | 239,000.00 | |
| Administrate -Shendetësi | | | 11,600.00 | | | | |
| Sherbimet e shendetësise Primare | | 40,000.00 | 40,000.00 | | | | 80,000.00 |
| Sherbimet sociale | | | 8,000.00 | | | | 8,000.00 |
| Sherbimet Sociale Rezidenciale | | | | | | | |
| Kulture rini dhe sport | | | 16,974.00 | | 38,500.00 | | 55,474.00 |
| Administrate-Arsim | | | | | | 30,000.00 | |
| Arsimi Parashkollor | | | | | | | |
| Arsimi Fillor | | | | | | | |
| Arsimi I Mesem | | 25,000.00 | | | | | 25,000.00 |
| TOTALI | | 65,000.00 | 298,074.00 | | 120,000.00 | 379,000.00 | 294,474.00 |

## Totali /10+21/

| Emri I Programit | Stafi | Paga dhe mditje | Mallra dhe sherbime | shpenzime komunale | Subvencione | Investime kapitale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e Kryetarit | 28 | 252,000.00 | 50,000.00 | - | 40,000.00 | - | 342,000.00 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | | 154,000.00 | 4,000.00 | - | - | - | 158,000.00 |
| Administrata dhe Personeli | 38 | 234,000.00 | 30,000.00 | - | - | - | 264,000.00 |
| Ceshtja Gjinore | 1 | 7,000.00 | 500.00 | - | - | - | 7,500.00 |
| Buxhet dhe Financa | 24 | 177,000.00 | 20,000.00 | - | - | - | 197,000.00 |
| Ekonomi dhe Diaspore | 5 | 33,000.00 | 8,000.00 | - | 10,000.00 | - | 51,000.00 |
| Infrastruktura Publike | 19 | 135,000.00 | 117,926.00 | 93,000.00 | - | 208,028.00 | 553,954.00 |
| Zjarrefikset dhe Inspektimet | 33 | 238,000.00 | 31,000.00 | - | - | - | 269,000.00 |
| Menaxhimi I katastrofave natyrore | 6 | 44,000.00 | 19,000.00 | - | - | 10,000.00 | 73,000.00 |
| ZLK | 8 | 49,000.00 | 2,000.00 | - | 1,500.00 | 50,000.00 | 102,500.00 |
| Bujqësi dhe Pylltari | 20 | 137,000.00 | 8,000.00 | - | 30,000.00 | - | 175,000.00 |
| Kadaster dhe Xheodezi | 10 | 67,000.00 | 9,000.00 | - | - | 20,000.00 | 96,000.00 |
| Urbanizem | 11 | 87,000.00 | 6,000.00 | - | - | 239,000.00 | 332,000.00 |
| Administrate -Shendetësi | 4 | 31,000.00 | 11,600.00 | - | - | - | 42,600.00 |
| Sherbimet e shendetësise Primare | 146 | 1,370,000.00 | 140,000.00 | 32,000.00 | - | 75,000.00 | 1,617,000.00 |
| Sherbimet sociale | 13 | 104,000.00 | 8,000.00 | - | - | - | 112,000.00 |
| Sherbimet Sociale Rezidenciale | 10 | 83,000.00 | 60,000.00 | 7,000.00 | - | 20,000.00 | 170,000.00 |
| Kulture rini dhe sport | 21 | 140,000.00 | 20,974.00 | - | 38,500.00 | - | 199,474.00 |
| Administrate-Arsim | 10 | 95,000.00 | 199,000.00 | 52,000.00 | - | 30,000.00 | 376,000.00 |
| Arsimi Parashkollor | 22 | 142,000.00 | 15,000.00 | - | - | - | 157,000.00 |
| Arsimi Fillor | 564 | 2,656,916.00 | 98,000.00 | - | - | - | 2,754,916.00 |
| Arsimi I Mesem | 193 | 1,310,000.00 | 42,000.00 | - | - | - | 1,352,000.00 |
| TOTALI | 1186 | 7,545,916.00 | 900,000.00 | 184,000.00 | 120,000.00 | 652,028.00 | 9,401,944.00 |

| | 2,015 | 2,016 | 2,017 | 2,018 | 2,019 | 2,020 | 2,021 | 2,022 | Diferenca | Progresi 1 | Progresi 2 | Progresi 3 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | 2019/2020 | 2019/2020 | 2020/2021 | 2021/2022 |
| Numri I Punetoreve | 1,166 | 1,172 | 1,172 | 1,172 | 1,186 | 1,186 | 1,186 | 1,186 | - | | | |
| Grandi I pergjitheshem | 3,073,614.00 | 2,846,901.00 | 3,061,912.00 | 3,804,967.00 | 3,841,099.00 | 4,129,292.00 | 4,355,027.00 | 4,612,030.00 | 288,193.00 | 107.50 | 105.47 | 120.07 |
| Grani I Arsimit | 2,818,346.00 | 2,591,842.00 | 2,625,630.00 | 3,061,088.00 | 2,956,524.00 | 3,089,906.00 | 3,105,356.00 | 3,120,883.00 | 133,382.00 | 104.51 | 100.50 | 105.56 |
| Huaja per Arsim M/SH | | | | 3,191.00 | 2,127.00 | | | | | | - | #DIV/0! |
| Huaja per Arsim Sh/K | | | | 2,127.00 | 1,418.00 | | | | | | - | #DIV/0! |
| Grandi I shendetesise | 853,158.00 | 853,158.00 | 893,702.00 | 983,072.00 | 1,082,550.00 | 1,150,672.00 | 1,196,698.44 | 1,244,566.00 | 68,122.00 | 106.29 | 104.00 | 108.16 |
| Huaja perShendetesi M/SH | | | | 86,604.00 | 86,604.00 | | | | - | | - | #DIV/0! |
| Sherbimet sociale rezidenciale | | 104,291.00 | 160,000.00 | 165,000.00 | 160,000.00 | 170,000.00 | 170,000.00 | 170,000.00 | 10,000.00 | 106.25 | 100.00 | 100.00 |
| Total Grandet | 6,745,118.00 | 6,396,192.00 | 6,741,244.00 | 8,014,127.00 | 8,040,173.00 | 8,539,870.00 | 8,827,081.44 | 9,147,479.00 | 499,697.00 | 103.36 | 103.63 | 103.36 |
| Total Huamarrja | | | | 91,922.00 | 90,149.00 | | - | | | | | |
| te hyrat vetanake | 986,433.00 | 850,000.00 | 899,181.00 | 943,989.00 | 1,229,125.00 | 862,074.00 | 924,247.00 | 986,430.00 | (367,051.00) | 70.14 | 107.21 | 106.73 |
| Totali | 7,731,551.00 | 7,246,192.00 | 7,640,425.00 | 9,050,038.00 | 9,359,447.00 | 9,401,944.00 | 9,751,328.44 | 10,133,909.00 | 42,497.00 | 100.45 | 103.72 | 103.92 |
| Paga dhe meditja | 6,405,668.00 | 5,954,554.00 | 6,766,498.00 | 7,131,057.00 | 7,114,526.00 | 7,545,916.00 | 7,958,613.44 | 8,301,446.00 | 431,390.00 | 106.06 | 106.06 | 111.86 |
| Mallra dhe sherbime | 495,515.00 | 653,765.00 | 600,002.00 | 870,954.00 | 956,558.00 | 900,000.00 | 900,000.00 | 900,000.00 | (56,558.00) | 94.09 | 100.00 | 100.00 |
| Shpenzime komunal | 160,700.00 | 180,700.00 | 140,005.00 | 140,005.00 | 184,000.00 | 184,000.00 | 184,000.00 | 184,000.00 | - | 100.00 | 100.00 | 100.00 |
| Subvencione | 122,332.00 | 100,567.00 | 9,125.00 | 9,125.00 | 200,000.00 | 120,000.00 | 150,000.00 | 150,000.00 | (80,000.00) | 60.00 | 125.00 | 75.00 |
| Investime Kapitale | 547,336.00 | 351,606.00 | **124,795.00** | **898,897.00** | **904,363.00** | **652,028.00** | **558,715.00** | **598,462.00** | (252,335.00) | 72.10 | 85.69 | 61.78 |
| TOTALI | 7,731,551.00 | 7,241,192.00 | 7,640,425.00 | 9,050,038.00 | 9,359,447.00 | 9,401,944.00 | 9,751,328.44 | 10,133,908.00 | 42,497.00 | 100.45 | 100.45 | 103.72 |

**Lista e Projekteve Kapitale per vitin 2020**

## KONKLUZIONET PËRMBYLLËSE :

- Kemi një rritje te buxhetit në krahasim me vitin 2019 për 0.45% apo ( 42.497.00€)
- Kemi një Grand të përgjithëshëm të rritur me vitin 2019 për 7.50% apo (288.193.00)
- Kemi rritje me vitin 2019 të Grandit të Arsimit prej 4.51% apo në shumë prej (133.382.00)€
- Kemi një Grand i Shëndetësisë të rritur në krahasim me vitin 2019 prej 6.29% apo 68.122.00
- Ka një Grand të Shërbimeve Sociale rezidenciale të rritur në krahasim me vitin 2019 prej 6.25% apo 10.000.00€
- Kemi zvoglim të planifikimit të të hyrave vetanake për 29.86% në krahasim me vitin 2019 në (367.051.00)€.
- Ka një rritje në kategori për paga dhe mëditje krahasuar me vitin 2019 prej 6.06% apo **(431.390.00€).**
- 
- Ka një zvoglim në kategori mallra dhe shërbime krahasuar me vitin 2019 prej 5.89% apo **56.558.00€.**
- Ka një ritem të njejtë në kategori shpenzime komunale krahasuar me vitin 2019
- Ka një zvoglim në kategori të subvencioneve krahasuar me vitin 2019 prej 40% apo **80.000.00€.**
- Ka një zvoglim në kategori Investime kapitale krahasuar me vitin 2019 prej 27.90% apo 252.335.00€.
- Grandi i Përgjithëshëm ndihmon Grandin e Arsimit me **1.149.010.00€**
- Grandi I përgjithëshëm ndihmon Grandin e Shëndetësisë me **386.328.00 €**

Më datë 30.08.2019

Kamenicë

Kryetari i Komunës:

Qëndron Kastrati